



K.DH.SH.II.nr.102/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “N...” Sh.p.k nga Gjakova, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit autorizuarit Shoqëria e Avokatëve “...” Sh.p.k, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1143/17, të datës 17.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.10.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “N...” Sh.p.k nga Gjakova, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1143/17, të datës 17.10.2019, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1143/17, të datës 17.10.2019, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit paditësit “N...” Sh.p.k nga Gjakova. Ndërsa nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, mbetet në fuqi vendimi nr.151/17 i datës 09.06.2017, i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi “N...” Sh.p.k nga Gjakova, përmesë të autorizuarit Shoqëria e Avokatëve “...” Sh.p.k me seli në Prishtinë, për shkak të aplikimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat

nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar nr. 151/2017 të dates 09.06.2017, të Administratës Tatimore të Kosovës - Departamenti i Ankesave, nën pikën I të dispozitivit të vendimit është refuzuar ankesa nr. 151/2017 e datës 25.04.2017, e subjektit “N...” Sh.p.k nga Gjakova, në mbështetje të nenit 136/a të Ligjit Nr.02/L-028 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në lidhje me nenin 89 par.2 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll, vërtetohen si të bazuara. Nën pikën II të dispozitivit të vendimit, procedura e ankesës nuk ndërprejë sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi sipas Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e të paditurës Administratës Tatimore të Kosovës – Departamenti i Ankesave, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 07.07.2017, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr. 151/2017 të datës 09.06.2017, të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e lartcekur. Me arsyetim se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë vlerëson se e paditura me të drejtë ka ngarkuar paditësin me detyrime tatimore shtesë për shkak të mungesës së regjistrimeve që parashihet me nenin 13 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, gjegjësisht neni 17 i Udhëzimit Administrativ 15/2010, ku paditësi është obliguar me tatim shtesë bazuar në informatat e palëve të treta. Gjykata e Shkallës së parë ka bërë administrimin e provave edhe përmes ekspertizës financiare të propozuar nga pala paditëse, ku nga dokumentacioni i paraqitur nga pala paditëse para kontrollit eksperti ka vërtetuar gjendjen sikurse ka rezultuar nga kontrolli duke prezantuar edhe tabelën e faturave tatimore të furnizuara nga paditësi dhe të verifikuara në llogarit bankare, të cilat furnizime nuk janë regjistruar dhe deklaruar nga paditësi. Gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur dëshmi që do të ndryshonte një gjendje tjetër nga gjendja e konstatuar nga e paditura në procedurën administrative të ankesave dhe atë të kontrollit, për arsye se tatimi shtesë që ka rezultuar për periudhën 11/2015-12/2015 nga furnizimet me mall nuk janë regjistruar dhe deklaruar nga paditësi. Andaj, Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se vendimi i lartcekur, është vendim i drejtë dhe i bazuar në dispozita ligjore.

Qendrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e pranon si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas

shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar të gjendjes faktike, dhe aplikim të gabuar të dispozitave materiale, ky pretendim nuk qëndron me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar, ku paditësi është ngarkuar me qarkullim shtesë për shkak të mos zbatimit të nenit 13 të ligjit 03/L-222 përkatësisht nenit 17 të Udhëzimit Administrativ 15/2010, fakti se paditësi nuk i ka zbatuar këto nene, nuk ka mundur të vërtetohet nga organi administrativ të paditurës, andaj në mungesë të provave e ka ngarkuar paditësin me qarkullim shtesë. Këto pretendime ankimore Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i aprovoj, sepse vlerësoj se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, me të drejtë ka konstatuar se me kontroll janë konstatuar parregullsi në regjistrimin dhe deklarimin e qarkullimit, respektivisht qarkullimi dhe tatimi shtesë për paditësin ka rezultuar nga të gjeturat e kontrollit, ku në rastin konkret mos pagesës së çmimit të plotë nga konsumatori i fundit që është dashur të paguhet, ku është nxjerrë mesatarja e çmimit të shitjes nga bizneset tjera që bëjnë shitje për klient të fundit. Pra, nga kjo gjendje faktike gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar si të bazuar vlerësimin e kontrollit dhe vendimin e kontestuar të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentoj me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe Raportin e Kontrollit të datës 16.06.2015, dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka konstatuar se paditura ka autorizime ligjore nga neni 14, 15 dhe 19 të Ligjit Nr.03/L222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku sipas paragrafit 2 të nenit 19 të Ligjit 03/L-222 parashihet: *“Vlerësimi i Drejtorit të përgjithshëm do të bëhet sipas gjykimit të tij ose saj më të mirë dhe do të bazohet në provat që ai ose ajo ka në dispozicion, përfshirë: librat, regjistrimet, kuponët, faturat ose informatat tjera përkatëse të personave të tretë, informatat nga personat të cilët mund të verifikojnë saktësinë e deklaratave, librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit, informatat tjera objektive rreth të ardhurave ose shitblerjeve të tatimpaguesit lidhur me detyrimin e tij, informatat e siguruara gjatë vizitave tek tatimpaguesi sikurse është paraparë në paragrafin 1 të nenit 14 të këtij Ligji dhe /apo ligjeve të aplikueshme të tatimeve në të ardhura apo TVSH në Kosovë”*. Pra, paditësi as në procedurë administrative tek e paditura, por as para gjykatës nuk ka arritur që të paraqes dëshmi konkrete dhe prova të besueshme se furnizimet me mall gjatë periudhës 11/2015-12/2015 nuk janë regjistruar dhe deklaruar për efekte tatimore nga paditësi. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se vlerësimi i ATK-së, është bazuar në provat në dispozicion dhe dispozitat ligjore të aplikueshme, përkatësisht neni 14, 15 dhe 19 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Prandaj, sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i aprovoi,

sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
K.DH.SH.II.nr.102/22, me datë 06.10.2022

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri